

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama apo shqiptarët, kush do të rezistojë më gjatë?
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/26/rama-apo-shqiptaret-kush-do-te-rezistoje-me-gjate/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 17:28:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 17:26:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c44afe9869abb6463e6455aa8f54fe3badecde07530eb5d448ecd81822c13fb5
TEKSTI	a4147f4294f63d1364857bd62b1a596ff9fe048f7b41dfdb708f2a9bbf3f16d
PAMJA	0a4a67eb256132faa27947302320667bfd24991db353416e2d1ba8a66fe4be85

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b67a4aef045a8be98f8cc5750a71b7865d2953c6149945f7813b3f37b919fe65
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f1d82a646bd703b2c3db300ad07fe31d63113d7410715c948367b3c04c7e5621
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b67a4aef045a8be98f8cc5750a71b7865d2953c6149945f7813b3f37b919fe65>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Rama apo shqiptarët, kush do të rezistojë më gjatë?

19:26 : 26/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE, KRYESORE, POLITIKE



Prestigjiozja gjermane Frankfurter Allgemeine Zeitung (FAZ) i ka kushtuar një shkrim të gjatë zhvillimeve të fundit politike në Shqipëri, protestave të të ashtuquajturit “Revolucioni i Flamingove” dhe përplasjes që lidhet me projektet turistike të Jared Kushner në Zvërnec dhe Sazan.

Në analizën e saj, gazeta gjermane ndalet edhe te kryeministri Edi Rama, të cilin e ka takuar në zyrën e tij në Kryeministri. FAZ përshkruan një Rama që nuk jep përshtypjen se ndihet i vënë në defensivë nga protestat, ndërsa vetë kreu i qeverisë pranon se situata përbën “një provë besimi”.

Matthias Rüb- FAZ

Prej më shumë se njëqind ditë, ata dalin çdo mbrëmje. Rreth orës 19:00 mblidhen në zemër të Tiranës dhe marshojnë përgjatë Bulevardit të Dëshmorëve. Afërsisht në gjysmën e rrugës ndodhet selia e kryeministrit, dorëheqjen e të cilit ata kërkojnë. Kur kortezhi i protestuesve mbërrin aty, thirrjet bëhen më të forta. Ndonjëherë, përpara godinës ka përplasje me efektivet e policisë dhe disa arrestime. Por, në shumicën e rasteve, protesta mbetet paqësore.

Kështu vazhdon mbrëmje pas mbrëmjeje. Gjatë ditëve të javës protestojnë dukshëm më shumë njerëz sesa në fundjavë. Atëherë, edhe protestuesit më këmbëngulës zgjedhin ndonjëherë të shkojnë në det, në vend që të jenë gjithmonë në rrugët e Tiranës.

Lexo edhe:[“Jep dorëheqjen”/ Nis protesta e 119-të kundër Ramës, qytetarët marshojnë drejt Kryeministrit](#)[“Tradhtar i kombit”/ Shqiptarët nuk ndalen kundër Ramës, vijojnë protestat në New York](#)

Këto të fundit mbushen më pas nga të rinjtë që dalin për të festuar. Ata festojnë të paktën po aq zhurmshëm dhe për po aq gjatë sa protestuesit demonstrojnë. Janë dy botë paralele që duket se nuk preken me njëra-tjetrën.

TË GJITHA

**Rama apo shqiptarët, kush do të rezistojë më gjatë?**

19:26 : 26/09/2026

**“Jep dorëheqjen”/ Nis protesta e 119-të kundër Ramës, qytetarët marshojnë drejt Kryeministrit**

19:08 : 26/09/2026

**“Tradhtar i kombit”/ Shqiptarët nuk ndalen kundër Ramës, vijojnë protestat në New York**

18:49 : 26/09/2026

**Investimet trilionatë dollarëshe në AI, basti më i madh ekonomik në historinë e SHBA-së**

18:36 : 26/09/2026

**“Nuk keni parë gjë akoma”/ Artan Hoxha: Nga dosja e SHISH kanë dalë vetëm dy faqe**

18:27 : 26/09/2026

**Kina dhe SHBA bien dakord për ulje tarifash prej 30 miliardë dollarësh dhe dialog për IA -në**

18:14 : 26/09/2026

**Emri/ Ishte dënues për vrasjen e bashkëshortes, 49-vjeçari i jep fund jetës në burgun e Reçit**

17:54 : 26/09/2026

E vetëshpallura “Revolucioni i Flamingove” në Shqipëri deri tani nuk është shndërruar në një lëvizje masive. Por ajo po tregon qëndrueshmëri. Të njëjtën gjë po bën edhe kreu i qeverisë, Edi Rama. Ai është në detyrë që prej vitit 2013 dhe është i vendosur të qëndrojë deri në përfundimin e mandatit në vitin 2029. Cila palë do të rezistojë më gjatë në fund?

Protestat në kryeqytetin shqiptar nisën në fund të majit. Shkak u bë ndërhyrja e dhunshme e punonjësve të një kompanie private sigurie pranë një gardhi që rrethonte një kantier ndërtimi. Gardhi ishte ngritur në skajin verior të gadishullit të Zvërnecit. Aty do të nisnin punimet paraprake për një projekt turistik luksoz.

Çfarë lidhjeje kanë flamingot me gjithë këtë?

Kundër projektit, të cilin po e çon përpara kompania e investimeve Affinity Partners e Jared Kushnerit, dhëndrit të Donald Trumpit, kishin protestuar në vendngjarje disa qindra demonstrues. Gjatë protestës pati përplasje pranë gardhit. Rojet e sigurisë i kishin tërhequr zvarrë protestuesit mbi zhavorr për t'i larguar nga gardhi i kantierit. Pamjet e filmuara me celular të ndërhyrjes, gjatë së cilës askush nuk pësoi lëndime serioze, u përhapën me shpejtësi në internet.

Por si mundi një incident relativisht i padëmshëm të shndërrohej në një lëvizje proteste kombëtare, e cila, të paktën sipas emrit, synon madje të çojë në një revolucion? Kjo lidhet edhe me flamingot, të cilat lëvizja i ka zgjedhur si simbolin e saj të dashur për përmbysjen që synon. Aktivistët mjedisorë duhen se kolonitë ku shumohen flamingot rozë dhe zogj të tjerë shtegtarë mund të rrezikohen nga bumi i turizmit në jug të Shqipërisë – konkretisht nga resortet luksoze të planifikuara nga investitorët arabë dhe katarianë të grupit Kushner. Habitatit i flamingove rozë është pikërisht Laguna e Nartës, një zonë e mbrojtur natyrore pranë Zvërnecit.

Lëvizja e Flamingove e akuzon qeverinë për korrupsion dhe kërkon që zonat e mbrojtura natyrore të zgjerohen sërish, që investitorët e mëdhenj të mos favorizohen më dhe që të zhvillohen zgjedhje të reja demokratike.

Fillimisht, Rama, i cili drejton Partinë Socialiste që prej vitit 2005 dhe qeverinë që prej vitit 2013, ishte përpjekur t'i kalonte protestat duke pritur që ato të shuheshin. Ai u kishte thënë protestuesve se nuk mund të shfaqeshin një ditë të bukur dhe të rrëzonin nga detyra kryeministrin e zgjedhur dhe qeverinë e tij. “Nuk funksionon kështu. Duhet të prisni deri në zgjedhjet e ardhshme.”

Ishte e vështirë ta kundërshtojë këtë argument. Rama dhe socialistët e tij kishin fituar zgjedhjet parlamentare të majit 2025 me më shumë se 52 për qind të votave. Ishte fitorja e katërt radhazi e socialistëve në zgjedhje, ndërkohë që Rama dhe Partia Socialiste kishin arritur ta rrisnin vazhdimisht përqindjen e votave.

Rama tani ka ndryshuar strategji

Megjithatë, pikërisht pasi kishte marrë mandatin më të fortë nga zgjedhësit, Rama u përball papritur me kërcënimin më serioz ndaj pushtetit të tij. Pothuajse dy muaj pas fillimit të protestave, Rama ndryshoi taktikë. Në vend që të vazhdonte t'u tregonte grushtin protestuesve përmes retorikës së tij, tani ai po i rreh miqësisht në shpatull. Protestat, thotë ai tani, janë shenjë e vitalitetit dhe stabilitetit të demokracisë shqiptare. Ai bën gjithashtu dallimin mes atyre që ngrënë një shqetësim legjitim dhe që duhen dëgjuar, dhe atyre që, sipas tij, po përdoren nga kundërshtarët e tij brenda dhe jashtë vendit për qëllimet e tyre politike.

Në një fjalim të zjarrtë përpara grupit parlamentar të socialistëve, në fund të korrikut, Rama paraqiti strategjinë e re të qeverisë. Ai foli për një krizë të thellë të besimit publik. Përpara figurave të rëndësishme të partisë së tij, të mësuara me sukseset zgjedhore, Rama u ankua për “paradoksin e suksesit”: sa më shumë të zhvillohet dhe të përparojë një shoqëri, aq më pak ajo vlerëson atë që është arritur dhe atë që funksionon, duke u përqendruar në vend të kësaj tek ajo që ende mungon dhe tek ajo që nuk funksionon.

Shoqëritë e varfra, tha ai, janë më tolerante ndaj mangësive, sepse karakterizohen nga mendësia se “mund të ishte edhe më keq”. Shqipëria e ka lënë pas këtë fazë dhe ka hyrë në një fazë të re, në të cilën mbizotëron qëndrimi se “mund të ishte edhe më mirë”. Për këtë arsye, tani nevojitet një “shtet që kujdeset”, i cili të dëgjojë dhe të marrë seriozisht përvojat e qytetarëve, të përmirësojë cilësinë e shërbimeve dhe investimeve të tij dhe, në këtë mënyrë, të forcojë besimin e qytetarëve te shteti.

Fjalimi i Ramës u prit, siç pritej, pozitivisht nga deputetët dhe funksionarët e Partisë së tij Socialiste. Përfanësuesit e lëvizjes së Flamingove e hodhën noshtë atë si një manovër

retorike për të larguar vëmendjen nga problemet kryesore: korrupsioni, mungesa e transparencës dhe shkatërrimi i mjedisit. Kreu i opozitës, Sali Berisha, nga Partia Demokratike konservatore, hodhi dyshimin se Rama e kishte hartuar me ndihmën e inteligjencës artificiale dokumentin prej 40 faqesh, të cilin Berisha e cilësoi si pa përmbajtje dhe, për më tepër, të formuluar keq.

Vetë Rama nuk të krijon përshtypjen se “Revolucioni i Flamingove” e ka vënë në defensivë. Ai na pret në zyrën e tij në Kryeministri. Atletet e bardha i ka poshtë tavolinës. Me pantallonat e zeza të gjera dhe pulovrën e zezë mban çorape të zeza. Në një varëse rrobash janë vendosur fanella basketbolli që ish-lojtari i kombëtares shqiptare i ka marrë si dhurata. Dollapët dhe raftet janë të mbushur plot me objekte të ndryshme arti.

Rama nuk beson se vendi ndodhet në një pikë kthese, aq më pak në një pikë kritike. “Por, pa dyshim, kjo është një provë besimi.” Ai përpiqet ta shohë gotën njëkohësisht gjysmë plot dhe gjysmë bosh: “Nëse dikush tjetër e sheh gotën gjysmë bosh, kjo është në rregull. Ai sheh më pak atë që kemi arritur dhe kërkon më shumë. Ndërsa ai që e sheh gotën gjysmë plot, dallon pikërisht atë që kemi arritur.”

Në parim, është një shenjë pozitive kur njerëzit dalin në rrugë... për biodiversitetin, për mbrojtjen e mjedisit dhe për çështje të tjera. “Për mua është një sfidë. Por kjo është diçka e mirë. Gjatë gjithë jetës sime politike, gjërat nuk kanë shkuar kurrë vërtet mirë kur nuk jam sfiduar. Zakonisht jam më i mirë kur sfidohem. A do të jem më i mirë edhe këtë herë? Shpresoj. Nuk e di. Koha do ta tregojë. E ardhmja do ta dëshmojë”, vijon ai.

“Nuk mund të flitet për një shitje”

Sa i përket shkakut të drejtpërdrejtë të protestave në Rivierën shqiptare, Rama kujton se kontakti i parë me Jared Kushner dhe Ivanka Trump për një investim të mundshëm në Zvërnec dhe në ishullin e Sazanit kishte ndodhur në një kohë kur Donald Trump nuk ishte ende (sërisht) president: “Jeta e Trumpit në atë kohë luhatej mes burgut dhe Shtëpisë së Bardhë.”

Rama thekson se fakti që, si kryeministër i Shqipërisë, angazhohet për tërheqjen e investimeve të huaja direkte në vendin e tij, veçanërisht në sektorin kyç të turizmit, nuk e bën atë vegël të Trumpit. Dhe perspektivën e një fluksi prej më shumë se katër miliardë eurosh në projektet e planifikuara nga Kushner dhe partnerët e tij, ai si kryeministër nuk mund ta shpërfillë thjesht, pasi duhet të veprojë në interes të vendit. Megjithatë, sipas tij, nuk mund të flitet për rrezikun e një “shitjeje” të Shqipërisë.

Etiketa: Edi Rama protesta

Lajme të lidhura



“Jep dorëheqjen”/ Nis protesta e 119-të kundër Ramës, qytetarët marshojnë drejt Kryeministrit

19:08 : 26/09/2026



“Tradhtar i kombit”/ Shqiptarët nuk ndalen kundër Ramës, vijojnë protestat në New York

18:49 : 26/09/2026



Ish-këshilltari i Ramës trajnoi Viora Hysenin? Media rumune zbulon lidhjen me “Gjeneralin e Zi”

11:42 : 26/09/2026



Kosova priste fjalën për UÇK-në, Rama flet për AI në OKB

22:38 : 25/09/2026



Plagjiatura godet sërisht PS/ Doktoratura e Taulant Ballës nën akuzë, kapitulli 5 i kopjuar

21:30 : 25/09/2026



Aktivisti thirrje Eric Wendt: Na jepni një dorë, duam të krijojmë një qeveri të fortë

20:12 : 25/09/2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.